

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit Aktekspertizë e thelluar për “Riaftësimi strukturor i ndërtesave në Njësitë Administrative 5, 6, Kashar, Krrabë ”(Pjesa III), të ndarë në lote si më poshtë vijon:

- **Loti i I-rë:** Aktekspertizë e thelluar për “Riaftësimi strukturor i ndërtesës nr. 2, në rr. Riza Tafili”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 22114311-5 (Projekte).

Vlera e fondit limit: 1,462,000 (një milion e katërqind e gjashtëdhjetë e dy mijë) lekë pa tvsh.

- **Loti i I-rë:** Aktekspertizë e thelluar për “Riaftësimi strukturor i ndërtesës nr. 2, në rr. Riza Tafili” me fond limit: 306,000 (treqind e gjashtë mijë) lekë pa tvsh

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas Shtojcës 9 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP 2.2.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a.** Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. Kjo kërkesë do të

konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe referuar legjislacionit në fuqi për taksat dhe tarifatat vendore dhe konkretisht ligjit Nr 9632 dt 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar me Ligjin3, Nr.142/2015.

b. Kopje të deklaratimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar** duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

c. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 dhe kështu përkatës të vitit 2025 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, nën 3.1/a, b, c dhe nën 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

d. Vërtetim i lëshuar nga shoqëria “Ujësjetel Kanalizime Tiranë” sh.a, i cili konfirmon pagesën e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit).

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhes të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8 të Dokumentave Standarte të Tenderit, Autoriteti/enti Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenin 39, pika 8 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*. Bashkia Tiranë nëpërmjet “Ujësjes Kanalizime Tiranë” shpreh si objektiv kryesor garantimin e shërbimeve jetike të furnizimit me ujë në territorin e Bashkisë Tiranë ku dhe një nga prioritet bazë është mbledhja e të gjithë detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë. Qëllimi i vendosjes së këtij kriteri është për të siguruar Autoritetin Kontraktor që për dhënien e kontratës të kontraktohen operatorë ekonomik të cilët nuk kanë detyrime të paslyera për furnizimit me ujë sipas objektin ku ushtrojnë aktivitetin, në Bashkinë e Tiranës. Vendsoja e këtij kriteri siguron institucionin e Bashkisë Tiranë edhe në rast detyrimesh të paslyera, operatorët ekonomik kanë periudhën e nevojshme kohore për të shlyer këto detyrime përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Vendosja e këtij kriteri është propozim me objektin e kontratës, për sa kohë është detyrim i cdo shoqërie shlyerja e detyrimeve të shërbimeve të furnizimit me ujë në territorin ku ushtron aktivitetin, konkretisht Bashkia Tiranë.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

1.Operatori Ekonomik duhet të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet,të realizuara gjatë tri viteve të fundit.

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e aktekspertizës ose projektimit, formularin e vlerësimit për realizimin e shërbimit të aktekspertizës/ projektimit dhe faturat tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat si dhe objekti i aktekspertizës/ projektimit së realizuar.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e aktekspertizës ose projektimit, formular vlerësimi/vërtetim për realizimin e shërbimit të aktekspertizës ose projektimit ku të shënohet vlera, afati i kontrates dhe objekti i aktekspertizës ose projektimit së realizuar si dhe faturat tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat si dhe objekti i aktekspertizës ose projektimit së realizuar.

c) Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën e bashkimit të operatoreve dhe prokurën e posacme, të deklaruara në fazën e tenderimit.

d) Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën bazë ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontratën e nënkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nënkontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Duke qenë se kjo procedurë prokurimi do të konkludojë me një kontratë shërbimi aktekspertizë për të deshmuar përvojën e

meparshme vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë: **Liçensa profesionale të operatorit ekonomik (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategorite:**

2. PROJEKTUES ARKITEKT

-Kat- 2/a- Projektim arkitekturor për objekte banimi- objekte industriale- objekte turistike

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

-Kat-3-a- Objekte civile- industriale turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate

-Kat-3/b-1-Objekte civile-industrial-turistik mbi 5 kate

-Kat-3/d- Vlerësimi I kapacitetit mbajtës dhe përforcimi I strukturave mbajtëse prej beton-arme, muraturë dhe metalike

4. PROJEKTUES INSTALATOR

-Kat 4-a- Projektim të instalimeve hidro-termosanitare

-Kat 4-c-Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industrial

8. PROJEKTUES TOPOGRAF/MARKSHAJDER/GJEODET

-Kat- 8/a -Rilevime inxhinierike

9. STUDIM GJEOLIGO INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK

-Kat- 9/a Studim/ vleresim gjeologo inxhinierik I truallit për objektet civile – ekonomike deri 5 kate

-Kat -9/b- studim /gjeologo – inxhinierik I truallit për objektet civile- ekonomike mbi 5 kate

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë licencën sipas legjislacionit përkatës përpara zhvillimit të fazës së dytë të tenderit.

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT ose institucione të tjera të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studim***

projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.

Argumentimi: Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në shërbimin që do të realizohet sipas objektit të prokurimit.

Operatori ekonomik që do të realizojë shërbimin e aktekspertizës duhet të zotërojë licensën profesionale me pikat e sipërpermendura.

Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”a” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 759 datë 28.12.2016 (i ndryshuar).

3. Një punësim mesatar i të paktën 3 (**tre**) personave, për periudhën të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për minimumin 3(tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

3.1 Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për minimumin 3 (tre) muajt të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

3.2 Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për minimumin 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

Argumentimi: Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosija e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është perlogaritur në një kohë të shkurtër i cili kërkon fuqi punëtore të shtuar dhe me mjetet e kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate. Gjithashtu Njësia e Prokurimit për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore dhe stabilitetin e saj ka kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në pikën 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

4. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha shërbimeve të aktekspertizës, të përfshirë në licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- 1 (një) Arkitekt
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Konstruktor)
- 1 (një) Inxhinier Elektrik

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), d), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(e ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të referencës, natyrës së përgjithshme të shërbimeve që priten të ofrohen. Meqenëse kemi të bëjmë me shërbimin e kryerjes së aktekspertizës dhe projektimit në ndërtim, prezencën e stafit të mesiperm është gjykuar si e domosdoshme dhe e nevojshme për një shpërndarje dhe efikasitet sa më të madh në realizimin e shërbimeve ;

5.Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë si pjesë të stafit mbështetës të shoqërisë, si poshtë:

- 1(një) Inxhinier topograf/markshajder/gjeodet
- 1(një) Inxhinier gjeolog

a)Për stafin e mesiperm Operatori ofertues duhet të paraqesë:

- Kontratat individuale të punës (të vlefshme)
- Licencat profesionale individuale në projektim
- Diplomë
- Curriculum Vitae

b)Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme”, operatorët pjesëmarrës si dhe operatorët mbështetës të deklaruar nga operatorët pjesëmarrës si subjekt mbështetës duhet të deklarojnë për stafin e kërkuar sipas pikës

5. të dhënat si më poshtë:

- Emër / Mbiemër
- Profilin e punës
- Numrin dhe datën e kontratës individuale të punës
- Numrin e licencës individuale profesionale në projektim
- Numrin dhe titullin e kualifikimit për diplomën si dhe institucionin që ka lëshuar dokumentin

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të referencës, natyrës së përgjithshme të shërbimeve që priten të ofrohen. Prezenca e stafit të mesiperm është

gjykuar si e domosdoshme dhe e nevojshme per nje shperndarje dhe efikasitet sa me te madh ne realizimin e sherbimeve konkretisht;

- Punimet per sherbimin e projekteve strukture jane te nje shkalle te ndryshme veshtiresie te cilat kerkojne gjykim dhe punime te specializuara si rilevime inxhinierike per te gjitha kategorite e objekteve subjekt i kesaj procedure ne te cilen kerkohet dhe staf ndihmes. Inxhinier topograf/markshajder/geodet do te duhet dhe ne rilevime e projektit si rrjedhoje gjykohet qe duhet te pakten **1 (nje) Inxhinier topograf/markshajder/geodet** pjese e stafit ndihmes.
- Punimet per sherbimin e projekteve strukture jane te nje shkalle te ndryshme veshtiresie te cilat kerkojne gjykim dhe punime te specializuara si studim/ vleresim gjeologo inxhinierik i trualit per objektet civile qe jane subjekt i kesaj procedure ne te cilen kerkohet dhe staf ndihmes. Inxhinier gjeolog do te duhet dhe ne studim/ vleresim gjeologo inxhinierik si rrjedhoje gjykohet qe duhet te pakten **1 (nje) Inxhinier gjeolog** pjese e stafit ndihmes.

6. Operatori/et ekonomik duhet te kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar për:

1 (nje) punonjës specialist “Ekspert Zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim” në përputhje me Ligjin Nr.152/2015 “Për sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin”, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate dhene nga Drejtoria MZSH.(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, të paktën njëri nga operatorët duhet të ketë pjesë të stafit të tij një specialist ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin).

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për *Ekspert Zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 41, si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Nr.152/2015, “*Për sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin*“, ku citohet se: “Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së jep certifikatë për personat fizikë e juridikë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat, në bazë të kriterëve të veçanta të miratuara me udhëzim të ministrit”.

- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, të paktën njëri nga operatorët duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”).

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave.Kjo kërkesë është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma (b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe në mbështetje të nenit 7 të Ligjit 10237,

datë 18.02.2010 *Për sigurinë dhe shëndetin në punë*“, sipas të cilit: *Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....*“.

6. Operatori Ekonomik duhet të zotërojë dhe të paraqesë një certifikate ISO 9001 -2015 (e vlefshme) për menaxhimin e cilësisë lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim. (Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit)

Argumentimi: *Kërkesat e mesipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit” Çertifikatat e cilësisë janë në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.*

a) ISO 9001: 2015, Per menaxhimin e cilësisë;
ISO 9001:2015 është një standard ndërkombëtar i menaxhimit të cilësisë që ndihmon organizatat të përmirësojnë proceset e tyre dhe të rrisin kënaqësinë e klientëve. Për shoqëritë që projektojnë dhe studiojnë projekte (studio projektimi), implementimi i këtij standardi është i rëndësishëm .

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Neni 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim në vëmendje se:

-Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë formularin e ofertës sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën 1, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

- Gjithashtu Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë edhe listën e çmimeve të shërbimeve i cili është vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

- Dokumentet perkatese vertetuese per disponimin e punonjësve do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit do t’i kërkojë ofertuesit të kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për

vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të paraqitura në sistemin elektronik të prokurimit gjatë fazës së ofertimit. Mosparaqitja e dokumentacionit të sipërcituar do të jetë kusht s'kualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimet e bëra në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.